

PROGRAMI SOCIAL-EKONOMIK

Çfarë synojmë?

Çdo qenie njerëzore duhet të ketë në fund të ditës një nivel të ardhurash që t'i garantojë jetesën dinjitoze. Prandaj në themel të programit tonë social-ekonomik qëndron domosdoshmëria e njohjes me ligj të minimumit jetik. **Ne do të luftojmë jo vetëm që shteti të njohë minimumin jetik**, por edhe që institucionet ta përllogarisin atë periodikisht e me saktësi. Kësisoj askush nuk do të ketë nevojë t'u shtrijë dorën të tjerëve.

Një shoqëri me rendin e duhur bazohet mbi punën e mirëpaguar e me të drejta. Shqipëria ka nevojë urgjente për **rritjen e pagave në sektorin privat e publik**. Kjo do të arrihej përmes rritjes së vazhdueshme të pagës minimale deri në arritjen e nivelit të pagës së jetueshme. Krahas saj, ne mendojmë se arsimimi i punëtorëve, së bashku me të drejtat në punë dhe organizimin human të vendit të punës, do të rrisnin produktivitetin dhe të mirat materiale e shpirtërore të shoqërisë.

Nuk ka punë me dinjitet nëse **punëtorëve** të duarve e të mendjes nuk u sigurohen **pushime javore e vjetore të mjaftueshme**. Pushimet duhet të shërbejnë si për ripërtëritjen fizike e mendore të punëtorëve, ashtu edhe për argëtimin, kulturimin dhe vetafirmimin e tyre. Si objektiv afatmesëm, duke marrë në konsideratë modelet më të mira botërore, ne do të luftojmë për një javë 35-orëshe pune për të gjithë njerëzit e punës.

Puna, si shtylla kryesore e jetës ekonomike të shoqërisë, duhet mbrojtur dhe fuqizuar përmes ligjeve dhe praktikave më të mira. Ne besojmë fuqishëm në rëndësinë e **organizimit sindikalist dhe kontratave kolektive të punës**. Shteti duhet të kontribuojë në drejtpeshimin e marrëdhënieve brenda vendit të punës, çka mund të arrihet vetëm nëse punëtorët organizohen masivisht në sindikata të pavarura dhe i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me punëdhënësin mbi bazën e kontratës kolektive. Një mënyrë për të nxitur shtrirjen e kontratave kolektive është që ato të bëhen të detyrueshme për ndërmarrjet e mëdha, si dhe për çdo sipërmarrje që fiton kontrata nga shteti.

Puna duhet të jetë baza e pensioneve të denja. **Pensioni minimal duhet të llogaritet në bazë të minimumit jetik**, ndërsa emergjenca e të pasiguarve duhet të zgjidhet duke e ulur moshën e përfitimit të pensionit social në moshën e daljes së zakonshme në pension. Ne mendojmë se lufta ndaj informalitetit në marrëdhëniet e punës dhe kontributet shtetërore për skemën e pensioneve do të mund ta përmirësonin ndjeshëm fatin e qytetarëve që prej një jete kanë kontribuar përmes punës së tyre në të mirën e përbashkët.

Një shoqëri vitale ka nevojë të inkurajojë të rinjtë dhe të mbështesë profesionistët, çka bëhet edhe më urgjente në kushtet e emigrimit masiv. **Lëvizja Bashkë beson te fuqia krijuese e të rinjve dhe te kapaciteti intelektual i profesionistëve.** Ashtu sikundër i qëndrojmë idesë se kushtet e barabarta dhe vlerësimi objektiv i aftësive duhet të jenë shtyllat e përparimit profesional e shoqëror. Ne do të luftojmë që çdo i ri të ketë mundësi të arsimohet e punësohet, ndërkohë që çdo profesionist të marrë vlerësimin material e shoqëror që meriton.

Lëvizja Bashkë sheh me përparësi çështjen e **barazisë gjinore** dhe luftën ndaj çdo diskriminimi. Këto synime mund të arrihen vetëm nëse një shtet i demokratizuar arrin që përmes ligjeve t'u kundërvihet me forcë rasteve të dhunës gjinore e identitare, të drejtpeshojë strukturën ekonomike të shoqërisë, si dhe të ndërmarrë fushata të gjithanshme edukuese e ndërgjegjësuese që synojnë të kultivojnë te çdo anëtar i shoqërisë idenë e barazisë dhe respektit ndaj tjetrit.

Emergjenca shëndetësore duhet të përballohet përmes investimeve të fuqishme shtetërore në spitalet publike, pajisjes së tyre me infrastrukturën dhe teknologjinë e duhur, si dhe nga mirëpagimi dhe respektimi i punës së mjekëve, infermierëve dhe punonjësve të tjerë shëndetësorë. Ne besojmë në parimin e **shëndetësisë publike falas dhe me cilësi të lartë**, që i garantohet kujtdo dhe kuron me përparësi ata që kanë më shumë nevojë. Ne jemi **kundër koncesioneve të shërbimeve spitalore**, sikundër u kundërvihemi të gjitha tentativave për të komercializuar spitalet publike, duke ua hedhur barrën e financimit pacientëve.

Po ashtu besojmë se bashkëveprimi midis strukturave shtetërore, mjekëve e infermierëve dhe komunitetit të pacientëve e familjarëve të tyre do të ishte përgjigjja e duhur ndaj korrupsionit në spitalet publike. Një sistem spitalor publik dinjitoz, ku jeta e shëndeti i njeriut mbrohen e fuqizohen, do të **ngushtonte shtrirjen abuzive të spitaleve private**, do të ulte kostot dhe do të specializonte shërbimet e tyre. Nga ana tjetër, informimi i vazhdueshëm i popullsisë për shëndetin dhe sëmundjet, i shoqëruar me fuqizimin e strukturave të gjurmimit dhe parandalimit të sëmundjeve, do të kontribuonin ndjeshëm në jetën e shëndetshme e të begatë të popullsisë.

Një popull i keqarsimuar është fatkeq. Ndaj ne vlerësojmë se arsimit cilësor – pa nepotizëm e abuzime, me mësues dhe edukatorë të përgatitur e të mirëpaguar – është një prej shtyllave më të rëndësishme të jetës shoqërore. Ne luftojmë për **arsim publik falas në të gjitha shkallët e veta**. Ne duam të ndërtojmë një shtet që siguron kujdesin e plotë e falas të fëmijëve që prej nivelit parashkollor. Ne synojmë që çdo njeri të kryejë së paku 12 vite shkollë, duke u formuar kështu edhe intelektualisht, edhe si qytetar. Shkolla duhet të na mbrujë me dije e kulturë, me zhvillim të kapaciteteve profesionale dhe një sens të fortë qytetarie. Po, mbi të gjitha, ne besojmë në **një sistem arsimor që kultivon te të rinjtë mendimin kritik e racional, krijimtarinë dhe respektin për tjetrin e shoqërinë**, duke u bërë kështu kontribuues i një jete kuptimplote.

Ne mendojmë se strehimi është një prej të drejtave themelore të njeriut, mosrespektimi i të cilës rrezikon një varg të drejtash të tjera. Prandaj luftojmë për **politika serioze të strehimit social të lirë e të qasshëm nga të gjithë**, sidomos nga shtresat e varfra të shoqërisë. Të varfrit dhe të gjithë ata që nuk mund të përballojnë kostot e qirave, duhet të kenë mundësi të jetojnë me qira të lira në banesa publike dhe, sipas praktikave më të mira botërore, pas disa vitesh të kenë mundësi t'i blejnë ato me çmime preferenciale. Ndërkohë shteti duhet të ndërhyjë përmes politikave tatimore që të **ulë çmimin e qirave në sektorin privat**, si dhe të reduktojë numrin e apartamenteve bosh, të cilat as përdoren për arsye banimi, as futen në tregun e shit-blerjes dhe qiradhënies.

Nevoja për lehtësim dhe përshpejtim të lëvizjes së qytetarëve kërkon ndërtimin e një sistemi publik transporti, i cili do t'u mundësonte të gjithëve të përdornin linja urbane e ndërurbane si alternativë ndaj automobilit. Në bashkitë e mëdha **shteti duhet të marrë në kontroll publik linjat e transportit urban**, duke u siguruar udhëtarëve **kushte dinjitoze transporti me çmim të lirë**. Për kategori të veçanta – si njerëzit me aftësi ndryshe, pensionistët, të papunët, studentët etj – transporti publik urban duhet të garantohet falas. Në transportin ndërurban duhet parë me përparësi rimëkëmbja e sistemit hekurudhor, ku qytetarët do të mund të udhëtonin lirë e shpejt. Të tilla masa jo vetëm do të lehtësonin trafikun dhe lëvizjen në qytet dhe mes zonave urbane, por edhe do të kishin një ndikim shumë të madh në reduktimin e ndotjes së mjedisit.

Jeta kuptimplotë në shoqëri kërkon edhe **mbrojtjen e trashëgimisë kulturore**. Trashëgimia materiale e shpirtërore e popullit tonë nuk duhet të bjerë pre e grykësisë së atyre që shohin fitim prej zhdukjes, tjetërsimit dhe komercializimit të saj. Ajo duhet të shërbejë si urë lidhëse me historinë, vlerat dhe botëkuptimin e paraardhësve tanë, si dhe të jetë objekt i reflektimit për të shkuarën dhe të ardhmen tonë si shoqëri.

Një shoqëri vitale ka nevojë për **nxitjen e veprimtarive sportive masive**. Fëmijët, të rinjtë dhe të gjithë qytetarët duhet të kenë hapësira të bollshme sportive për t'u argëtuar individualisht e kolektivisht, si dhe për të fuqizuar shëndetin e tyre. Sporti është një prej nxitësve kryesorë të solidaritetit shoqëror dhe frymës së bashkësisë.

Ne mendojmë se një shoqëri e begatë ka nevojë për **politika sigurie që rrisin kapacitetet mbrojtëse të vendit**, garantojnë kontrollin civil e demokratik mbi institucionet e sigurisë, vendosin në **kontroll publik aeroportet dhe portet kryesore të vendit** dhe ndërtojnë partneritet serioz me vendet demokratike.

Si do t'i materializojmë?

Shqipëria ka nevojë për **zhvillim të qëndrueshëm**, i cili ndërthur rritjen ekonomike, punësimin e plotë, rritjen e produktivitetit të punës dhe rishpërndarjen e pasurisë, me mbrojtjen e mjedisit dhe jetën kuptimplotë. Zhvillimi i vendit kërkon progresin e sektorëve kyçë të ekonomisë kombëtare, si bujqësia, turizmi dhe industria.

Nuk ka vend të zhvilluar në të cilën një pjesë e madhe e forcave të punës janë në bujqësi, ndërkohë që produktiviteti bujqësor është mjaft i ulët. Ne synojmë që, përmes politikave nxitëse dhe mbështetëse, prej subvencioneve të hopi teknologjik, të **sigurojmë një rritje të hovshme të produktivitetit bujqësor**, e cila do të mundësonte njëherësh sigurinë ushqimore të vendit dhe përmirësimin e bilancit tregtar përmes eksporteve.

Vendi ynë duhet të përdorë me zgjuarsia avantazhet e veta natyrore në fushën e turizmit. Katastrofa urbano-turistike e tri dekadave të fundit duhet të ndreqet përmes **planifikimit të zhvillimit turistik**, i cili duhet të mbështetet mbi sipërmarrjet e vogla e familjare, të cilat do të rrisnin cilësinë e shërbimeve në një mjedis sa më natyror. Ne nuk mendojmë se turizmi i korporatave, që shpronëson banorët vendas dhe ngre kështjella prej betoni në bregdet, mund të krijojë një mjedis turistik të shëndetshëm dhe nxitës të ekonomisë.

Kriza ekonomike kërkon që **institucionet publike të rimarrin në kontroll pasuritë e nëntokës shqiptare**, nga **nafta e kromi** të mineralet e tjera. Investimet e zgjuara publike jo vetëm do të rrisnin kapacitetet nxjerrëse të minierave e puseve naftëmbajtëse, por edhe do të ofronin siguri pune për punëtorët. Hopi zhvillimor i ekonomisë së nëntokës nuk mund të jetë i plotë pa rindërtimin e **industrive përpunuese të mineraleve dhe naftës**. Përmes politikave nxitëse dhe, sipas mundësive, investimeve shtetërore, Shqipëria mund të përdorë për nevojat e veta dhe të eksportojojë produkte të përpunuara, vlera e të cilave është mjaft më e lartë sesa thjesht eksportimi bruto.

Më gjerësisht, ne synojmë që **Shqipëria të rrisë kapacitetet e veta industriale** jo vetëm në industrinë ushqimore e tekstile, duke u ngjitur në zinxhirin global të prodhimit, por edhe në sektorë të rinj, ku me përparësi duhet trajtuar puna konjitive. Arsimiti i vazhdueshëm i punonjësve, përgatitja e tyre për të kryer punë gjithnjë e më komplekse, si dhe krijimi i një mjedisi motivues pune do të rrisnin produktivitetin e punës dhe mirëqenien e punonjësve dhe të mbarë shoqërisë.

Lëvizja Bashkë mbështet bizneset e vogla dhe familjare, duke inkurajuar specializimin e tyre në produkte e shërbime. Aty ku është e mundur dhe mbi bazën e vullnetit të lirë të njërive të vogla ekonomike, duhet nxitur krijimi i **sipërmarrjeve të përbashkëta**, të cilat do të reduktonin kostot dhe do të rrisnin cilësinë e produktit e të shërbimit.

Një shoqëri e begatë dhe papunësia e pavullnetshme nuk shkojnë bashkë. Ndaj ne mendojmë se përmes politikave të forta publike dhe nxitjeve të sektorit privat **të sigurojmë punësimin e sa më shumë qytetarëve në moshë pune**, të aftë për punë dhe të paangazhuar në shkollë. Problemi i papunësisë është i lidhur ngushtë edhe me informalitetin në punë dhe punën me kohë të pjesshme. Ndaj një shtet i mirëfilltë social nuk do të lejonte që mbi askënd të imponohej informaliteti në punë. Nga ana tjetër vëmendje duhet t'u kushtohet edhe njohjes dhe shpërblimit të drejtë të punës së kujdesit, sidomos në mjediset familjare.

Shumë nga politikat e mësipërme kërkojnë rritje dhe rialokim të buxhetit të shtetit. Buxheti mund të rritet duke **luftuar seriozisht krimin e organizuar, praktikat korruptive** dhe duke reduktuar informalitetin në ekonomi.

Sot Shqipëria është e përmbytur nga paraja e pistë, produkt i veprimtarive kriminale e korrupsionit qeveritar. **Sekuestrimit dhe përdorimit për interesin publik i pasurive kriminale e korruptive** do të përbënin një faktor të rëndësishëm të rritjes së buxhetit të shtetit dhe progresit ekonomik.

Sot shteti shqiptar u paguan çdo muaj oligarkëve dhjetëra miliona euro për **koncesione e partneritete publike-private korruptive** e rëndom të panevojshme. **Hetimi dhe revokimi i tyre** do të siguronte fonde për investime publike të domosdoshme.

Prej dekadash buxheti i shtetit e ka pësuar prej haraçeve të marra nga pushtetarët për leje e licenca, në vend që të taksoheshin ndershmërisht përfituesit e tyre. Përmbysja e kësaj logjike do t'u jepte frymëmarrje ekonomisë dhe buxhetit të shtetit.

Edhe për qëllimet e mësipërme, Shqipërisë i duhet **themelimi i shtetit të së drejtës**, ku **institucionet gjyqësore të jenë të pavarura** nga degët e tjera të pushtetit, por të varura fund e krye nga kushtetuta dhe ligji. Ligjshmëria duhet të jetë garancia e qytetarit të thjeshtë dhe frenuesja e çdo abuzimi me të mirën publike dhe të drejtat e çdo qytetari.

Lufta ndaj monopoleve dhe nxitja e konkurrencës në ekonomi jo vetëm do të rrisnin cilësinë e produkteve e shërbimeve, por edhe do të ulnin çmimet e tyre, duke siguruar kështu zgjerimin e vazhdueshëm të veprimtarive ekonomike dhe ngritjen e nivelit të jetesës.

Ne besojmë fort te parimi dhe efektiviteti i **taksimit progresiv**. Kush nxjerr të ardhura përmes punës duhet të taksohet më pak se ata që përfitojnë përmes spekulimit. **Kush zotëron më shumë pasuri duhet të paguajë më shumë** se të papronët dhe pronarët e vegjël. Kush fiton të ardhura të larta duhet të paguajë më shumë se njerëzit me të ardhura të ulëta e mesatare. Kjo rishpërndarje ekonomike do të mbështeste përmirësimin dhe qasjen e barabartë në shërbimet publike, do të zgjeronte bazën e ekonomisë duke siguruar kushte të barabarta dhe do të kontribuonte ndjeshëm në aktualizimin e parimeve të drejtësisë shoqërore.